REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 2-180/1636
Nr. i fax.
Data 06/03/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/15
Datë:27.02.2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 8 dhe nenit 20 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, nenit 13 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, nenit 7 dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 2004/15 për Transportin Rrugor, si dhe në përputhje me Statutin e Komunës së Junikut dhe kompetencat komunale në fushën e shërbimeve publike, mbrojtjes dhe menaxhimit të emergjencave, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tijë të rregullt të mbajtur më 27.02.2026 nxjerrë:

V E N D I M

Për inicimin e procedurave për hartimin e planeve strategjike të Komunës së Junikut, të cilat janë në kompetencë të Drejtorisë për Shërbime publike,inspeksion,mbrojtje dhe shpëtim.

I. Miratohet inicimi i procedurave për hartimin e planeve strategjike sektoriale të Komunës së Junikut, të cilat janë në kompetencë të Drejtorisë për Shërbime Publike, Inspeksion,Mbrojtje dhe Shpëtim.

II. Planet strategjike që do të hartohen janë:

1. Plani Komunal i Vlerësimit të Rrezikut,
2. Plani Komunal për Reagim Emergjent,
3. Plani i Transportit Publik dhe Mobilitetit,
4. Plani për Mirëmbajtjen e Rrugëve dhe Hapësirave Publike,
5. Plani për Mirëmbajtjen e Rjetit të Ujësjellësit dhe Kanalizimit,
6. Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave,
7. Plani Komunal për Menaxhimin dhe Kontrollin e Qenve me dhe pa Pronar.

III. Qëllimi i hartimit të këtyre planeve është planifikimi strategjik dhe zhvillimi i qëndrueshëm i shërbimeve publike komunale, përmirësimi i menaxhimit të infrastrukturës publike dhe sistemeve komunale, rritja e kapaciteteve institucionale për reagim në situata emergjente, përmirësimi i mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit publik dhe rritja e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët.

IV. Për hartimin e planeve do të themelohen grupe punuese sektoriale të përbëra nga përfaqësues të drejtorive komunale relevante, institucioneve publike, ndërmarrjeve publike, ekspertëve të fushave përkatëse dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

V. Procesi i hartimit të planeve strategjike do të përfshijë analizën e gjendjes aktuale, identifikimin e prioriteteve strategjike, konsultime publike me qytetarët dhe palët e interesit, harmonizimin me strategjitë dhe politikat zhvillimore dhe hartimin e planeve të veprimit me masa konkrete dhe afate për zbatim.

VI. Planet strategjike të hartuara do t'i paraqiten Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.

VII. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës së Junikut, përkatësisht Drejtoria për Shërbime Publike,Inspeksion,mbrojtje dhe shpëtim e cila do të koordinojë procesin e hartimit të planit.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Kryetari i Komunës së Junikut,
- Drejtoria për shërbime publike,inspeksion,mbrojtje dhe shpëtim,
- Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
- Arkivi i Komunës së Junikut

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Llolluni